

DOKUMENTET E KËRKUARA PËR DËMSPËRBLIM

A. PËR DËME MATERIALE

a. Njoftimi/kërkesa e palës së dëmtuar për dëmshpërblim.

Pala e dëmtuar duhet të plotësojë të gjitha hapësirat e njoftim-kërkesës për dëmshpërblim, sipas formatit (Formulari nr. 1), gjithashtu të shpjegojë me hollësi rrethanat e ngjarjes.

b. Procesverbali i konstatimit të shkeljes nga Policia Rrugore për ngjarjen.

Procesverbali i konstatimit të shkeljes nga Policia Rrugore konsiderohet i rregullt kur ai është lëshuar në përputhje me dispozitat e Kodit Rrugor.

c. Vendimi përfundimtar i Prokurorisë për ngjarjen, kur në aksident rezultojnë vdekje dhe/ose plagosje.

d. Vendimi i formës së prerë i gjykatës (për përgjegjësitë në aksident, kur rasti është gjykuar nga gjykata) ose vendimi i prokurorisë kur çështja është pushuar.

e. Vendim mosfillimi i procedimit penal i prokurorisë, kur në legjislacionin përkatës nuk parashikohet fillimi i këtij procedimi, por që vërteton rastin e sigurimit, i shoqëruar nga dokumentacioni përkatës i Vendimit (ekspertiza autoteknike, skica e vendit të ngjarjes, tabela fotografike etj.).

f. Dokumenti i pronësisë së mjetit ose objektit të dëmtuar:

- Fatura e blerjes së mjetit në dyqan, ose
- Libreza / Leja e Qarkullimit, ose
- Kontrata e shit-blerjes së mjetit, ose
- Certifikata e pronësisë, ose
- Kontrata e akt-dhurimit për mjetet motorike,
- Kontrata e shit-blerjes, hipoteka, apo çdo dokument tjetër zyrtar - për objektet e tjera të dëmtuara.

g. Leje drejtimi dhe ID të pronarit/përdoruesit të mjetit përfitues.

Ky dokumentacion pasi kontrollohet nga specialisti i pranimit i shoqërisë së sigurimit, do të administrohet në praktikë të fotokopjuar duke u sigluar nga specialisti që pranon dokumentacionin. Dokumentet e mësipërme për mjete me targë regjistrimi të huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të vërtetuara me origjinalin.

h. Fotografi të mjetit shkaktar të dëmit.

Fotografia e mjetit shkaktar të dëmit duhet të paraqesë në mënyrë të qartë mjetin në tërësi me targën dhe pjesët e dëmtuara si rrjedhojë e ngjarjes.

B. PËR DËME SHËNDETËSORE

Përveç dokumenteve të parashikuara për dëmet materiale (shkronjat a-h), kërkohen edhe:

p. Certifikata familjare dhe Letër Njoftimi/Dokumenti i Identitetit (ID).

Certifikata familjare e personit të dëmtuar, në rastin e paaftësisë së përhershme (pjesore ose totale) dhe të përkohshme, duhet të jetë sipas formatit zyrtar, e firmosur dhe vulosur nga organi kompetent.

q. Vërtetimi i të ardhurave neto personale për tre vitet e fundit (duke filluar nga data e aksidentit), i detajuar për çdo muaj, lëshuar nga punëdhënësi dhe konfirmuar nga organet e sigurimeve shoqërore ose tatim-taksa.

Për dëmet shëndetësore me pasojë vdekje, përveç atyre të mësipërme (a-q), kërkohen:

- Skeda e vdekjes,
- Certifikata e vdekjes,
- Vendimi i Gjykatës për përcaktimin e trashëgimtarëve të të ndjerit.

Për dëmet shëndetësore me paaftësi të përhershme, përveç atyre të mësipërme (a-q), kërkohen:

- Raporti i paaftësisë së përhershme për punë, i cili duhet të shprehë në përqindje masën e paaftësisë, duke u bazuar në tabelën "Shkalla e humbjes së paaftësisë së përhershme në punë".
- Radiologji / skaner / rezonancë manjetike / epikrizë anameze, fletështrimi dhe fletëdalje nga spitali dhe çdo dokument tjetër të lëshuar nga organi kompetent që ndihmon në vlerësimin e dëmit.

Për dëmet shëndetësore me paaftësi të përkohshme, përveç atyre të mësipërme (a-q), kërkohet:

- Raporti i paaftësisë së përkohshme, i cili duhet të jetë sipas Modelarit Tip të lëshuar nga organi kompetent.

AFATET E TRAJTIMIT TË KËRKESËS

Shoqëria e sigurimit është e detyruar të trajtojë kërkesën për dëmshpërblim dhe të njoftojë për masën e dëmshpërblimit apo refuzimin e saj:

- **Për dëme jo pasurore: brenda 90 ditëve nga data e plotësimit të dokumentacionit.**
- **Për dëme pasurore: brenda 30 ditëve kalendarike nga data e plotësimit të dokumentacionit.**